



**Raporti ISS COVID-19 • n. 1/2020**

**Përditësuar më 7 mars 2020 2020**

# **UDHËZIME AD INTERIM PËR REALIZIMIN E IZOLIMIT DHE ASISTENCËS SANITARE NË SHTËPI NË KONTEKSTIN AKTUAL COVID-19**

## **Grupi i Punës ISS Parandalim dhe Kontroll të Infeksioneve**

Fortunato “Paolo” D’Ancona, Instituti Superior i Shëndetësisë, Roma

Antonella Agodi, Universiteti i Katantias, Katania

Luigi Bertinato, Instituti Superior i Shëndetësisë, Roma

Paolo Durando, Universiteti i Xhenovas, Xhenova

Ottavio Nicastro, Qarku Emilia-Romanja, Bolonja

Maria Mongardi, Qarku Emilia-Romanja, Bolonja

Angelo Pan, ASST Kremona, Kremona

Annalisa Pantosti, Instituti Superior i Shëndetësisë, Roma

Nicola Petrosillo, Instituti Kombëtar për Sëmundjet Infektive

Gaetano Privitera, Universiteti i Pizës, Piza

Me bashkëpunimin e Benedetta Allegranzi, Organizata Botërore e Shëndetësisë

Grupi i Punës ISS Parandalim dhe Kontroll të Infeksioneve. *Udhëzime ad interim për realizimin e izolimit dhe asistencës sanitare në shtëpi në kontekstin aktual covid-19*. Versioni i datës 7 mars 2020. Romë: Instituti Superior i Shëndetësisë; 2020 (Raport ISS COVID-19, n.1/ 2020)

© Istituto Superiore di Sanità 2020  
viale Regina Elena, 299 –00161 Roma

## **Hyrje**

Izolimi i mirëfilltë i rasteve dhe kontakteve të COVID-19 është një masë shumë e rëndësishme e shëndetit

publik që kryhet për të shmangur shfaqjen e rasteve të tjera dytësore të shkaktuara nga transmetimi i virusit SARS-CoV-2 dhe për të shmangur mbingarkesën e sistemit spitalor. Rastet e individëve që duhet të vetë izoloohen në shtëpi për 14 ditë dhe të monitorohen në shtëpi (ose në një strukturë të veçantë në rast të një vendbanimi të papërshtatshëm) janë:

1. Të afërmit e rrethit të parë të rastit
  - Individë pa simptoma, (të cilëve nuk u duhet bërë testi): izolim deri në 14 ditë nga kontakti i fundit me rastin (karantinë);
  - Individë me simptoma të ngjashme me gripin të cilëve u bëhet testi; nëse rezultojnë pozitivë: izolim deri sa testi të dalë negativ dhe të jenë zhdukur simptomat;
  - Individë me simptoma të ngjashme me gripin të cilëve u bëhet testi; nëse rezultojnë negativë: izolim deri në 14 ditë nga kontakti i fundit me rastin.
2. Pacientë që dalin nga spitali e që janë klinikisht të shëruar, akoma pozitivë ndaj COVID-19.

**Ky udhëzues adresohet për menaxhimin e individëve të prekur nga COVID-19 të cilët kanë nevojë për zbatimin e masave paraprake për të shmangur transmetimin e virusit në individë të tjerë.**

## **Asistenca sanitare e individëve të izoluar në shtëpi**

### **Detyrat e operatorit të shëndetit publik**

Operatori i shëndetit publik dhe shërbimet për shëndetin publik kompetentë të zonave përkatëse, pasi kanë konstatuar nevojën për të filluar mbikëqyrjen shëndetësore dhe vetë izolimin, do të kenë për detyrë të informojnë mjekun e përgjithshëm / pediatrin, të individit të izoluar në shtëpi dhe në bashkëpunim dhe marrëveshje me të, informojnë në mënyrë të hollësishme të interesuarin mbi masat që duhet të merren, duke ilustruar, nëse ekzistojnë kushtet, me demonstrim praktik metodat dhe qëllimet në mënyrë që të sigurohet aderimi maksimal. Është përgjegjësi e shërbimeve të shëndetit publik kompetente për territorin që të sigurojnë maska kirurgjikale për ata që janë në izolim në shtëpi.

Operatori i shëndetit publik duhet ndërkaq të:

- konstatojë mungesën e temperaturës ose simptomave të tjera të personit që po vendoset në izolim, si dhe të çdo bashkëjetuesi tjetër;
- informojë personin për simptomat, karakteristikat e transmetimit (ngjitjes), metodat e transmetimit të sëmundjes, masat që duhet të zbatohen për të mbrojtur çdo bashkëjetues në rast të shfaqjes së simptomave;
- informojë personin për nevojën për të matur temperaturën e trupit dy herë në ditë (në mëngjes dhe në mbrëmje).

Detyrat e Mjekut të përgjithshëm, përpos të tjerave, përfshinë:

- Të kontribuojë për të informuar të interesuarin së bashku me operatorin e shëndetit publik për masat që duhet të merren për izolimin në shtëpi;
- Të sigurohet që raportet të dërgohen në departamentin e shëndetit publik në lidhje me fillimin ose përkeqësimin e simptomave në lidhje me individët që ndodhen në izolim në shtëpi;
- Të vlerësojë vlefshmërinë e simptomave të raportuara edhe përmes vizitave në shtëpi nëse është e nevojshme;
- Të kujdeset për aktivizimin e sistemit të urgjencës.

## Sjellja e individit për të garantuar një izolim të efektshëm

### Masat parandaluese që duhet të merren në izolim shtëpie dhe ndihma ndaj individit në izolim

- Personi që i nënshtrohet izolimit në shtëpi duhet të qëndrojë në një dhomë të dedikuar me ajrosje të mirë, të ketë një banjë të dedikuar, të flejë vetëm dhe të kufizojë, sa më shumë që të jetë e mundur, lëvizjet në zona të tjera të shtëpisë ku ka njerëz të tjerë;
- Nëse është vetëm një banjë në dispozicion, pas përdorimit të pastrohet me produkte që kanë bazë klori (zbardhues) me përqendrim 0.5% klori aktiv ose me 70% alkool
- Është e nevojshme që ambientet që strehojnë individin në izolim në shtëpi të jenë të ajrosura rregullisht për të siguruar një nivel të pranueshëm ndërrimi ajri.
- Në prani të njerëzve të tjerë, duhet të ruhet një distancë prej të paktën një metër dhe çdo kontakt i drejtpërdrejtë (përfshirë shtrëngime duarsh, puthje dhe përçafime) duhet të shmanget në mënyrë kategorike. Duhet të shmanget edhe kontakti i drejtpërdrejtë me njerëzit e tjerë që i nënshtrohen izolimit në shtëpi. Një përjashtim mund të bëhet për një nënë që ushqen me gji. Nëna duhet të vendosë një maskë kirurgjikale dhe të bëjë larje me kujdes të duarve para se të ketë kontakt të ngushtë me fëmijën.
- Shmangni çdo mënyrë të mundshme të ekspozimit përmes përdorimit të objekteve të përbashkëta, duke përfshirë peshqirët, shamitë ose çarçafët, pjatat, gotat, lugët, pirunët, thikat, etj. Enët e kuzhinës duhet të lahen me kujdes me sapun normal.
- Ndalohen udhëtimet, lëvizjet nga një vend në tjetrin dhe keni detyrim për të qëndruar arritshëm për aktivitetet e mbikëqyrjes.
- Nëse personi në izolim nuk ka simptoma, nuk mund të vizitohet deri sa të kenë kaluar 14 ditët e izolimit. Nëse pacienti ka simptoma, ndalimi i vizitave apo kontaktit me të tretë qëndron aktiv derisa të vërtetohet shërimi klinik edhe nëse kanë kaluar 14 ditë nga kontakti me rastin pozitiv dhe pritet konfirmim laboratorik. Ndalimi vazhdon deri në shërim (shiko fjalorthin).
- Nëse subjekti në izolim ka simptoma të infeksionit të traktit respirator kur lëviz nga dhoma e tij, duhet të përdorë një maskë kirurgjikale, dhe të marrë masa të higjienës së frymëmarrjes: të mbulojë hundën dhe gojën duke përdorur shami kur teshtin ose kollitet, kollituni në bërryl; shamitë mundësisht të jenë prej letre dhe duhet të depozitohen në dy qese (njëra brenda tjetrës) të papërshkueshme nga uji të vendosur në një kosh të mbyllur që nuk kërkon kontakt me duart për tu hapur (p.sh. hapje me pedale). Nëse shamitë janë prej cope, ato duhet të preken me doreza dhe të lahen në lavatriçe në 60-90° me pastrues të zakonshëm. Pas përdorimit të shamisë, duart duhet të lahen menjëherë me sapun dhe ujë tërësisht për 40 sekonda ose të fërkohen me një produkt hidro-alkoolik.
- Personat që ndihmojnë subjektin duhet të mbajnë një maskë kirurgjikale (kjo e fundit nuk duhet të preket gjatë përdorimit dhe duhet të ndryshohet nëse është e lagësht ose dëmtohet). Maskat nuk mund të ripërdoren, por duhet të eliminohen në një dopjo qese të papërshkueshme nga uji të vendosur në një kosh të mbyllur me hapje me pedale.
- Bashkëjetuesit dhe personat që ofrojnë ndihmë duhet të shmangin sa më shumë që të jetë e mundur kontaktin e drejtpërdrejtë me personin në izolim. Nëse ndihma përfshin kontakt me sekrecione të frymëmarrjes, feces ose urinë, duhet të përdoren doreza, të cilat më pas duhet të hidhen me kujdes në një qese të papërshkueshme nga uji në një kosh të mbyllur me hapje me pedale, e më pas të bëhet larja e duarve. Dorezat nuk mund të përdoren përsëri.

- Të paktën një herë në ditë, ose më shumë, sipërfaqet e ambienteve të përdorura nga subjekti në izolim duhet të pastrohen me produkte larëse dhe më pas të dezinfektohen me produkte me bazë klori (zbardhues) me një përqendrim prej 0.5% klori aktiv ose me alkool 70%) me vëmendje të veçantë për të gjitha sipërfaqet e prekura shpesh. Kushdo që pastron duhet të veshë një përparëse sanitare një përdorimesh (ose një përparëse të dedikuar) dhe doreza një përdorimesh; nëse përdoren doreza shtëpiake të trasha që ripërdoren, duhet të dezinfektohen pas përdorimit (larja duhet të bëhet me ujë dhe detergjent dhe më pas duhen dezinfektuar në të gjithë sipërfaqen e tyre me produkte me bazë klori (zbardhues) në një përqendrim prej 0.5% klori aktiv ose me alkool 70%).
- Personi që kujdeset për heqjen e ndërresave dhe çarçafëve të personit në izolim duhet të vendosë maskë kirurgjikale dhe doreza. Ndërresat dhe çarçafët duhet të vendosen në një qese të veçantë dhe të trajtohet veçmas nga ato të pjesës tjetër të familjes ose komunitetit dhe mund të lahet në lavatriçe me 60° për të paktën tridhjetë minuta ose në kohë më të shkurtër me temperatura më të larta duke përdorur detergjent të zakonshëm.
- Mbetjet e prodhuara nga subjekti në izolim ose nga ndihma e dhënë atij / asaj duhet të hidhen në një qese plastike të dyfishtë që do të mbyllet dhe vendoset në një kosh të mbyllur.
- Edhe pse aktualisht nuk ka asnjë provë që të tregojë se kafshët siç janë qentë ose macet mund të jenë një burim infeksioni për njerëzit, për qëllime thjesht parandaluese, personave të infektuar me SARS-CoV-2 u këshillohet të kufizojnë kontaktin me kafshët, në mënyrë të ngjashme siç bëhet me njerëzit e tjerë të familjes, duke shmangur, për shembull, puthjet ose ndarjen e ushqimit.

### **Vetë monitorimi i gjendjes shëndetësore**

- Subjekti në mënyrë të pavarur duhet të vërejë dhe të mbajë shënim temperaturën e trupit të tij çdo ditë dy herë në ditë dhe sipas nevojës, duke shënuar edhe vendin në trup se ku e ka kryer matjen.
- Subjekti duhet t'i raportojë Mjekut të përgjithshëm / Pediatrit dhe operatorit të shëndetit publik fillimin e simptomave të reja ose ndryshime të rëndësishme në simptomat para-ekzistuese. Në rast të përkeqësimit të simptomave, ai duhet të vendosë maskën kirurgjikale dhe të largohet nga bashkëjetuesit e të qëndrojë në dhomën e tij me derën e mbyllur, duke pritur transferimin në spital nëse është e nevojshme.
- Në rast të fillimit të vështirësive në frymëmarrje, subjekti duhet të kontaktojë 127, duke njoftuar mjekun e tij të përgjithshëm nëse është e mundur.

Monitorimi çdo ditë i kushteve shëndetësore të këtyre individëve në izolimi në shtëpi është nën përgjegjësinë e Operatorit të shëndetit publik, në bashkëpunim me Mjekun e përgjithshëm / Pediatrin

Shërbimet e shëndetit publik kompetente përkatësisht në territore të ndryshme duhet në çdo rast të garantojnë një numër telefoni në dispozicion për monitorimin e subjekteve për të reduktuar kohën e përgjigjeve dhe për të lehtësuar ardhjen në ndihmë të Mjekëve të përgjithshëm.

### **Praktikat e rekomanduara për asistencën shëndetsore të njerëzve në izolim nga operatorët sanitarë:**

- Operatorët sanitarë, të cilët i ofrojnë kujdes të drejtpërdrejtë subjektit në izolim (shembull: ekzaminim fizik), duhet të veshin këmisha një përdorimesh, maska kirurgjikale, mbrojtje për sytë dhe doreza, dhe pasi të kenë hequr mbrojtëset, duhet të higjienizojnë me kujdes duart me solucione hidro-alkoolike ose me ujë dhe sapun nëse nuk ka ose nëse duart janë dukshëm të pista.

- Maskat dhe dorezat nuk mund të ripërdoren.
- Udhëzimet lidhur me higjienizimin e sipërfaqeve, rrobave dhe mbetjeve janë të njëjtat me ato të raportuara te asistencat e rasteve

Theksohet mundësia për formimin e duhur të punonjësve të shëndetësisë dhe në rast se bëhen të nevojshme manovrat invazive, këshillohet ekzekutimi i tyre nga ekipe specifike të trajnuara në mënyrën e duhur.

Sugjerohet gjithashtu, kur është e mundur, të realizohet, përmes formave të raportimit të incidenteve, të adaptuara/përdorura nga organizatat shëndetësore, raportimin e mundshëm të ngjarjeve të lidhura me sigurinë e pacientëve (p.sh. mospërputhjet me indikacionet e duhura të institucioneve ministrore/rajonale dhe procedurave të kompanive), me qëllim promovimin e veprimeve korrigjuese dhe përmirësuese.

## **Mbështetje sociale e individëve në izolim në shtëpi (karantina dhe asistencat shëndetësore në shtëpi)**

Izolimi në shtëpi kërkon masa të mbështetjes sociale për sjelljen e duhur në karantinë. E kjo duhet të realizohet përmes bashkëpunimit të shërbimeve shëndetësore publike të zonës, shërbimeve sociale të administratave komunale, shoqatave vullnetare të zonës.

Si më poshtë funksionet që duhen garantuar:

1. Verifikimi i kushteve të strehimit dhe shpërndarja e pajisjeve mbrojtëse
2. Verifikimi që pacienti respekton kushtet e izolimit
3. Numër i dedikuar i shërbimit shëndetësor publik kompetent për territorin
4. Lidhje me Mjekun e përgjithshëm
5. Mbështetje për nevojat e jetës së përditshme për njerëz të vetmuar apo pa një kujdestar/caregiver (mbështetje e rrjetit të familjes dhe lagjes)
6. Një pikë e qartë referimi për nevojën sociale, e aftë për të aktivizuar përgjigjet përfshirë mbështetjen psikologjike të popullatës

## **Fjalorth**

### **Kontakt i ngushtë**

Kontakti i ngushtë i një rasti të mundshëm ose të konfirmuar është përcaktuar (Qarkorja e Ministrisë së Shëndetësisë 0006360-27 / 02/2020) si:

- një person që jeton në të njëjtën shtëpi të një rasti COVID-19;
- një person që ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë fizik me një rast COVID-19 (p.sh. shtrëngimi i dorës);
- një person që ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë të pambrojtur me sekrecionet e një rasti COVID-19 (për shembull prekja me duar të zhveshura të shamive të përdorura);
- një person që ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë (ballë për ballë) me një rast COVID-19,

- në një distancë më të vogël se 2 metra dhe që ka zgjatur më shumë se 15 minuta;
- një person që ka qenë në një ambient të mbyllur (për shembull në klasë, sallë takimi, sallë pritjeje në spital) me një rast të COVID-19 për të paktën 15 minuta, në një distancë prej më pak se 2 metra;
  - një operator sanitar ose një person tjetër që i ofron ndihmë të drejtpërdrejtë një rasti COVID-19 ose personel laborator që merret me mostrat e një rasti COVID-19 pa përdorur pajisje mbrojtëse të rekomanduara ose duke përdorur pajisje mbrojtëse të papërshtatshme;
  - një person që ka udhëtuar me avion duke u ulur në dy vendet ngjitur, në çfarëdo drejtimi, me një rast COVID-19, shoqërues udhëtimi ose persona ndihmës dhe anëtarë të ekuipazhit në pjesën e avionit ku rasti ishte ulur (nëse rasti ka një simptoma të rënda ose ka lëvizur brenda avionit, duke shkaktuar ekspozim më të madh të pasagjerëve, konsiderohen si kontakt i ngushtë të gjithë pasagjerët të ulur në të njëjtën seksion apo në të gjithë avionin).
  - Kontaktet e ndodhura brenda një periudhe 14 ditore para fillimit të sëmundjes në rastin në fjalë do të konsiderohen të rëndësishme për qëllime epidemiologjike.

### **Pacient i shëruar**

Përkufizohet (C. MdS. 6607-29 / 02/2020) një pacient i shëruar klinikisht nga COVID-19 ai i cili, pasi ka paraqitur manifestime klinike (ethe, rinitit, kollë, dhimbje të fytyrës, eventualisht dispnea dhe, në rastet më të rënda, pneumoni me insufiçencë të frymëmarrjes) të lidhura me infeksionin e dokumentuar virologjikisht nga SARS-CoV-2, bëhet asimptomatike për shkak të zgjidhjes së simptomave klinike të pranishme. Subjekti i shëruar klinikisht mund të jetë ende pozitiv në testin SARS-CoV-2. Pacienti i shëruar është ai që zgjidh simptomat e infeksionit COVID-19 dhe që rezulton negativ në dy teste radhazi, të bëra në 24 orë distancë, në gjetjen e SARS-CoV-2